

**LIGJ nr.7582 datë 13.07.1992**

**PËR NDËRMARRJET SHTETËRORE**

**(I azhornuar me Ligjin nr.7670 datw 09.02.1993 dhe Ligjin nr.7743 datw 26.07.1993)**

**Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991,**

**"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,**

**KUVENDI POPULLOR**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Ky ligj përcakton regjimin juridik të ndërmarrjeve shtetërore të cilat, në përputhje me objektin e parashikuar në aktin e krijimit të tyre, ushtrojnë veprimtari prodhimi, tregtie, apo shërbimi duke pasur si qëllim realizimin e fitimit dhe shtimin e pasurisë.

**Neni 2**

Ndërmarrjet shtetërore janë njësi ekonomike dhe kanë personalitet juridik. Shteti është zotërues i vetëm i kapitalit të këtyre ndërmarrjeve dhe, për rrjedhojë, ushtron të drejtat e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij ligji.

**Neni 3**

1. Ndërmarrjet shtetërore krijohen me vendim të organeve të administratës shtetërore, qendrore ose lokale.
2. Ndërmarrjet shtetërore e fitojnë personalitetin juridik pas regjistrimit në gjykatë dhe në organin financiar të juridiksionit ku kanë qendrën e tyre, sipas rregullave të përgjithshme.

**Neni 4**

Ndërmarrjet shtetërore mund të krijojnë filiale të cilat kanë personalitet juridik dhe ushtrojnë veprimtarine e tyre nën kontrollin e ndërmarrjes.

**Neni 5**

Ndërmarrjet shtetërore, përveç rasteve kur me dispozita të veçanta parashikohet ndryshe, e ushtrojnë verpimtarinë e tyre në të njëjtat kushte si dhe ndërmarrjet e tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me dispozitat e këtij ligji. Ato veprojnë në kushtet e konkurrencës së lirë e të ligjshme dhe nuk gëzojnë asnjë privilegj ose të drejtë që prish kushtet e kësaj konkurrence.

## **Neni 6**

1. Ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë vetë programin ekonomik e financiar dhe marrin vendime për realizimin e tij duke respektuar legjislacionin në fuqi.

2. Ndërmarrjet shtetërore përcaktojnë lirisht çmimet e mallrave apo shërbimeve, në bazë të kërkesës e ofertës me përjashtim të atyre rasteve që përcaktohen me dispozita të veçanta.

3. Ndërmarrjet shtetërore sigurojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre ekuilibrin financiar duke i shitur prodhimet, mallrat apo shërbimet në tregun e brendshëm apo të jashtëm.

Ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë jobuxhetorë lejohen të marrin e t'i japin kredi subjekteve shtetërore a privatë për blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve të tyre. Këshilli i Ministrave rregullon me dispozita të veçanta kushtet dhe afatet specifike të këtyre kredive

## **Neni 7**

Ndërmarrjet shtetërore, që venë në shfrytëzim pasuri kombëtare të një rëndësie të veçantë, marrin parasysh në programet e tyre ekonomike e financiare edhe detyrimet që rrjedhin nga programet e përgjithshme të shtetit për zhvillimin e ekonomisë apo të degëve të veçanta të saj. Këshilli i Ministrave mund të parashikojë për këto ndërmarrje forma të tjera organizimi, përfshirë edhe bashkësi ekonomike, si dhe statuse të posaçme, por pa prishur kushtet e përgjithshme të këtij ligji.

## **Neni 8**

Ndërmarrjet shtetërore mbajnë kontabilitet, përgatitin e paraqesin llogaritë vjetore dhe raportojnë periodikisht treguesit dhe të dhënat statistikore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 9**

1. Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve shtetërore verifikohen dhe vërtetohen nga një ose disa kontrollorë të jashtëm, kushtet profesionale dhe personale të të cilëve parashikohen me dispozita të veçanta. Ky kontroll është i pavarur nga kontrollet e parashikuara me dispozita ligjore të tjera dhe nuk i zëvendëson ata.

2. Kontrollorët e llogarive caktohen për një periudhë 4-vjeçare nga organi i administratës shtetërore, i cili emëron edhe këshillin drejtues të ndërmarrjes.

## **Neni 10**

1. Drejtori i ndërmarrjes paraqit periodikisht dhe detyrimisht në mbyllje të çdo viti, raport për veprimtarinë ekonomike e financiare të ndërmarrjes.
2. Raporti vjetor i veprimtarisë pasi miratohet nga Këshilli Drejtues i ndërmarrjes, i dërgohet organit të administratës shtetërore përkatëse, bashkë me llogaritë vjetore të vërtetuara sipas kritereve të caktuara në nenin 9 të këtij ligji.
3. Raporti vjetor i veprimtarisë ekonomike e financiare të ndërmarrjes u bëhet i njohur, nëpërmjet përfaqësuesve të sindikatave, edhe punonjësve të ndërmarrjes.

## **Neni 11**

1. Ndërmarrjet shtetërore e përdorin shumën e fitimit vjetor të realizuar, pas zbritjes të tatimit, për qëllimet dhe sipas rradhës që vijon:

- për krijimin e rezervës të kapitalit
- për krijimin e rezervës për zhvillim
- për krijimin e rezervës për ndihma sociale
- për krijimin e rezervës për shpërblim suplementar të punonjësve
- për krijimin e rezervave të tjera

2. Shteti nuk tërheq nga ndërmarrja shtetërore pjesë të fitimit, përveç detyrimit që rrjedh nga legjislacioni tatimor.

## **Neni 12**

Rezerva e kapitalit në ndërmarrjet shtetërore krijohet çdo vit deri sa shuma e saj të arrijë jo më pak se një e dhjeta e shumës së kapitalit. Ajo llogaritet jo më pak se 5 për qind mbi shumën e fitimit vjetor, që mbetet pas zbritjes të humbjeve të mbartura nga viti ose vitet pasardhës, në se ka të tilla humbje.

## **Neni 13**

1. Rezerva për shpërblime suplementare të punonjësve llogaritet mbi të njëjtën shumë të fitimeve si në nenin 12 dhe jo më shumë se 15 për qind.

2. Ndërmarrjet shtetërore mund të shpërndajnë shpërblime suplementare për punonjësit vetëm kur disponojnë rezervën përkatëse dhe jo më shumë se 2 paga mujore në vit për secilin punonjës.

## **Neni 14**

1. Ndërmarrjet i përballojnë humbjet e pësuarat, gjatë ushtrimit të veprimtarisë vjetore, me anë të rezervës së kapitalit. Nëse kjo rezervë mungon ose është e pamjaftueshme, shuma e humbjes të pambuluar mbartet në vitin pasardhës.

2. Shteti nuk financon humbjet e ndërmarrjes shtetërore, përveç se me ligj, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kjo ka të bëjë me subvencionimin e çmimeve të kontrolluara sipas miratimit të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 15**

1. Ndërmarrja shtetërore garanton dhe përgjigjet me pasurinë e saj për të gjitha detyrimet ndaj të tretëve.

2. Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e ndërmarrjes shtetërore ndaj të tretëve.

### **Neni 16**

Ndërmarrjet shtetërore i nënshtrohen procedurës së falimentimit në rastet dhe në mënyrën e parashikimit nga legjislacioni përkatës.

## **KREU II**

### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI**

#### **Neni 17**

Ndërmarrja shtetërore organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të këtij ligji.

#### **Neni 18**

1. Organi drejtues i ndërmarrjes shtetërore është Këshilli Drejtues.

2. Këshilli Drejtues është organ kolegjal që realizon drejtimin e veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore.

#### **Neni 19**

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë dhe jo më shumë se 7 anëtarë.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe midis tyre, drejtori emërohet për një periudhë katërvjeçare nga ministri, drejtuesi i institucionit tjetër qendror ose nga organi i pushtetit lokal, të cilët kanë edhe të drejtën e shkarkimit me një vendim të motivuar. Ata mund të riemërohen.

3. Anëtarët e Këshillit Drejtues si rregull ushtrojnë edhe funksionet drejtuese teknike në ndërmarrje.

4. Pagat dhe modalitet për shpërblimet suplementare të anëtarëve të Këshillit Drejtues përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 20**

Këshilli Drejtues ka të gjitha atributet për të vepruar në emër dhe për llogari të ndërmarrjes. Ai ushtron të drejtat e tij duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

## **Neni 21**

1. Këshilli Drejtues mblidhet sa herë e kërkon interesi I ndërmarrjes, por si rregull jo më pak se një herë në muaj.
2. Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues e ka drejtori i tij, ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të këshillit.
3. Mënyrat e thirrjes së Këshillit Drejtues si dhe procedurat e mbledhjes përfshihen në rregulloren e ndërmarrjes shtetërore.

## **Neni 22**

Këshilli Drejtues shqyrton probleme të ndryshme vetëm në rastet kur është e pranishme jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Ai i merr vendimet me shumicë votash të anëtarëve që e përbëjnë. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e drejtorit është përcaktuese. Këshilli Drejtues mban librin e drejtimeve dhe procesverbal, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e tij.

## **Neni 23**

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes shtetërore merr vendime kolegjiale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për këto çështje kryesore:

1. Për krijimin ose shkrirjen, bashkimin ose ndarjen e filialeve.
2. Për pjesëmarrjen e ndërmarrjes shtetërore në kapitalin e ndërmarrjeve dhe të shoqërive të tjera, vendase a të huaja.
3. Për përcaktimin e pagave të punës, rritjen e tyre dhe shpërblimin suplementar të punonjësve.
4. Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme të marrjes në punë dhe të largimit nga puna të punonjësve.
5. Për shkarkimin nga funksionet teknike të një anëtari të Këshillit Drejtues me propozim vetëm të drejtorit të ndërmarrjes.
6. Për shitjen dhe dhënien me qira të mjeteve kryesore të saj.

7. Për lidhjen e kontratave të huadhënies.

8. Për lidhjen e kontratave të huamarrjes në tregun kombëtar ose në tregje ndërk ombëtare.

9. Për rregulloren e brendshme të funksionimit të ndërmarrjes dhe problemet sociale që lidhen me kushtet e përgjithshme të punës.

10. Për miratimin e llogarive vjetore dhe të raportit vjetor të veprimtarisë ekonomike e financiare të ndërmarrjes.

#### **Neni 24**

1. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore përfaqëson ndërmarrjen në të gjitha marrëdhëniet e saj juridike dhe administrative. Ai nënshkruar, nën përgjegjësinë e tij, veç të tjerave, edhe kontratat që lidhen nga ndërmarrja.

2. Drejtori i ndërmarrjes ka të drejtën të japë urdhëra dhe udhëzime dhe të vendosë sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Drejtori i ndërmarrjes mund t'ia kalojë të drejtën e nënshkrimit njërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kjo e drejtë mund të revokohet në çdo kohë.

#### **Neni 25**

Çdo kontratë a marrëveshje ndërmjet ndërmarrjes nga njëra anë dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues nga ana tjetër është e ndaluar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj.

#### **Neni 26**

Drejtori i ndërmarrjes dhe anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues, sipas rastit, janë përgjegjës individualisht ose bashkërisht ndaj shtetit, ndaj ndërmarrjes dhe ndaj çdo personi të tretë për çdo shkelje që ata i bëjnë legjislacionit në fuqi, dispozitave të këtij ligji, si dhe për dëmet që mund t'i sjellin ndërmarrjes si pasojë e drejtimit nga ana e tyre.

#### **Neni 27**

Punonjësit e ndërmarrjes përfaqësohen në Këshillin Drejtues nga një i deleguar i cili zgjidhet nga sindikata që ka numrin më të madh të anëtarëve në ndërmarrje. Ai merr pjesë gjatë shqyrtimit të problemeve nga Këshilli Drejtues. Ai nuk ka të drejtë vote.

#### **Neni 28**

Këshilli Drejtues i ndërmarrjes shtetërore nuk mund të marrë një vendim, pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e sindikatave në ndërmarrje, për çështjet e parashikuara në pikat 3, 4 dhe 9 të nenit 23 të këtij ligji.

## **KREU III**

### **BASHKIMI, NDARJA DHE LIKUIDIMI I NDERMARRJES**

#### **Neni 29**

Shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri aksionare ose në forma të tjera shoqërisht bëhet sipas legjislacionit e rregullave në fuqi.

#### **Neni 30**

Organi shtetëror i cili emëron Këshillin Drejtues të ndërmarrjes mund të vendosë, me propozimin e Këshillit Drejtues ose para konsultave me të, ndarjen e ndërmarrjes apo shkrirjen e pjesëshme ose tërësore të saj, duke e bashkuar me një a disa ndërmarrje të tjera shtetërore.

#### **Neni 31**

Në rast falimentimi likuidimi i ndërmarrjes shtetërore bëhet në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi. Pas kryerjes së likuidimit, teprica e mbetur i kthehet shtetit.

## **KREU IV**

### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **neni 31/a**

Personat përgjegjës në ndërmarrjet shtetërore, për kryerjen e pagesave me lekë në dorë mbi limitin ditor të arkës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë deri në 5 mijë lekë. Të drejtën e gjobës e kanë punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe bashkisë për Tiranën.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë të dhënë nga punonjësit e seksionit të financës të rrethit dhe të bashkisë për Tiranën ankimi bëhet në përputhje me procedurën e caktuar nga ligji nr.7697 datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

#### **Neni 32**

Ky ligj zbatohet për të gjitha ndërmarrjet shtetërore që e kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë krijuar para apo pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 33**

Këshilli i Ministrave cakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 34**

Ligji nr.7523, datë 6.11.1991 "Për ndërmarrjet shtetërore" dhe nr.7565, datë 20.5.1992 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7523, datë 6.11.1991 "Për ndërmarrjet shtetërore", si dhe çdo akt që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

### **Neni 35**

Ky ligj hyn në fuqi një muaj pas shpalljes së tij.